

Data e publikimit dhe hyrjes në fuqi të rregullave të promocionit: _____

RREGULLAT E PROMOCIONIT PËR BLERJE NË PARASHITJE

Samsung Galaxy S26 12/512 GB
Samsung Galaxy S26+ 12/512 GB
Samsung Galaxy S26 Ultra 12/512 GB

1. Organizatori i promocionit, objekti i promocionit

Samsung Electronics Austria GmbH, Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri (në vijim: “**Samsung**”), organizon promocion për blerësit e telefonit të ri Samsung Galaxy S26, konkretisht modelet Samsung Galaxy S26 12/512 GB, Samsung Galaxy S26+ 12/512 GB, Samsung Galaxy S26 Ultra 12/512 GB (në vijim së bashku: “**Pajisja**”) në parashitje.

2. Pjesëmarrësit në promocion, periudha promionale

Promocioni në fjalë është i disponueshëm për përdoruesit përfundimtarë të Pajisjes (përdoruesit përfundimtarë janë ekskluzivisht persona fizikë dhe juridikë nga territori i Republikës së Kosovës që e kanë blerë Pajisjen për nevoja të veta, dhe jo për nevoja të rishitjes dhe shpërndarjes së mëtejshme), të cilët kanë adresë dorëzimi në territorin e Republikës së Kosovës dhe që plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në këto Rregulla.

Kohëzgjatja e promocionit (“**Periudha promionale**”) lidhur me Pajisjen është nga data 25.02.2026 deri më 10.03.2026, ose më herët në rast të mbarimit të stokut të Pajisjeve ose dhuratave të parashikuara për këtë promocion.

3. Përfitimet e promocionit, kushtet për pjesëmarrje në promocion

Këto Rregulla rregullojnë kushtet e pjesëmarrjes në promocionin në fjalë. Promocioni u mundëson pjesëmarrësve që gjatë periudhës promionale nga 25.02.2026 deri më 10.03.2026, te partnerët shitës të Samsung të përmendur në pikën 4 të këtyre Rregullave, në parashitje, të përfitojnë këto avantazhe:

- të blejnë telefonin Samsung Galaxy S26 12/512 GB me çmimin e telefonit Samsung Galaxy S26 12/256 GB;
- të blejnë telefonin Samsung Galaxy S26+ 12/512 GB me çmimin e telefonit Samsung Galaxy S26+ 12/256 GB;
- të blejnë telefonin Samsung Galaxy S26 Ultra 12/512 GB me çmimin e telefonit Samsung Galaxy S26 Ultra 12/256 GB.

Telefoni Samsung Galaxy S26 Ultra 1TB nuk përfshihet në promocionin në fjalë, përkatësisht në përfitimet e përcaktuara me këto Rregulla.

SHËNIM:

Partnerët shitës të Samsung të përmendur në pikën 4 të këtyre Rregullave përcaktojnë në mënyrë të pavarur çmimin me pakicë të Pajisjeve që janë objekt i këtij promocioni, prandaj çmimet me pakicë të Pajisjeve mund të ndryshojnë në varësi të partnerit shitës të Samsung nga i cili është blerë Pajisja.

Lista e partnerëve shitës të Samsung

- Neptun
- Aztech
- Wish by tech
- Gjirafa
- Gjirafa Mall
- Ipko
- Shopaz
- Tech Kosova

Dorëzimi i Pajisjeve të blera

Afatet dhe kushtet e dorëzimit të Pajisjeve që janë objekt i këtij promocioni, të cilat janë blerë gjatë periudhës së këtij promocioni, përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secili partner shitës i Samsung i përmendur në pikën 4 të këtyre Rregullave, pranë të cilit janë blerë Pajisjet.

E drejta për ndryshimin e rregullave të promocionit

Samsung rezervon të drejtën që, në çdo kohë, për arsye të arsyetuara, të bëjë ndryshime në këto Rregulla, me detyrimin që t'i publikojë ato pa vonesë.

Kontakt

Adresa e emailit për kontakt lidhur me promocionin në fjalë: